



Kryesia e Shoqatës Humanitare Garana(Zvicer), bashkë me Shoqatën si motër në Amerikë „Garana e Bashkuar“, në mbledhjen e mbajtur më datë 07/02/15 sollën vendim që për vitin 2015, të punsojnë dy puntorë për mirëmbajtjen e varrezave dhe rrugëve në fshatin Garanë.

Lartësia e mjeteve me të cilat SH.H. „Garana“ në Zvicer dhe Amerikë paguan puntorët është 3000 Fr. për vit respektivisht 250 Fr. në muaj.

Me këtë rast shpallim :

KONKURS

Për plotsimin e dy vendeve të punës si puntorë për mirëmbajtjen e varrezave dhe rrugëve të fshatit.

Konkursi mbetet i hapur nga 26.02.2015 deri në 31.03.2015.

Të drejtë konkurimi kanë të gjithë ata që plotsojnë kushtet e përcaktuara nga Sh.H. „Garana“ Zvicër dhe Amerikë.

Kushtet e përgjithëshme:

- Të jenë banor të f.Garanë
- Të mos jenë të punësuar në vend tjetër.
- T'i përmbahen rregullores së punës.

Të gjithë të interesuarit për informata shtesë të kontaktojnë koordinatoren e shoqatës FADIL EMINI().

Të gjitha informatat e kandidatve do të shqyrtohen dhe verifikohen me kujdes nga kryesitë e shoqatave dhe do të sillen vendimi se cilët konkures i plotësojnë kushtet për fitimin e vendit të punës.

www.shoqatahumanitaregarana.com

shoqatagarana@gmail.com

Rregullorja e punës për puntorët në mirëmbajtjen e varrezave dhe rrugët e fshatit

- Orari i punës fillon në ora 8 :00 të mëngjesit dhe mbaron në ora 16 :00 pasdite me pauze në ora 12-13h.
- Brenda javës mbeten të angazhuar 5 dite punë.
- Dy ditë të javës janë të lira dhe ato caktohen paraprakisht me marreveshje.
- Lejohet mungesa nga orari dhe vendi i punës në qoftë se paraprakisht arsyetohet mungesa me ndonjë nevojë urgjente(smundje,raste etj).
- Rroga paguhet për muaj të punuar në date të caktuar paraprakisht.
- Te punesuarit angazhim kryesorë në punën e tyre kanë mirëmbajtjen e varrezave dhe punë tjera në fshat si me poshtë :
- Mirëmbajtjen e varrezave,pastrimin e tyre nga bari,drunjtë,ferrat dhe cfardolloy papastertie.
- Në ditë rasti angazhohen në hapjen e varrit së bashku me dy veta të angazhuar nga vetë familjarët.
- Mirëmbajtjen e rrethojës së varrezave
- Mirëmbajtjen e oborreve të xhamiave
- Punë dhe angazhime në fshat si më poshtë :
- Pastrimi i rrugëve të fshatit nga cdo pengesë
- Krasitja e gardheve përgjat rrugëve
- Hapjen,pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve,vijave anësore të rrugëve për largimin e ujërave atmosferik.
- Pastrim dhe mirëmbajtje e hapsirave gjelbëruese publike të fshatit.
- Angazhim i tyre në përgaditjen e ndonjë aktiviteti me karakter publik.
- Të punesuarit obligohen që të jenë të përgjegjshëm në punë,komunikim dhe sjellje.
- Kësaj rregulloreje i përmbahen pa imponim dhe cdo mospërmabjtjeje do të sanksionohet me largim nga vendi i punës.